

URDHËR
Nr. 83/1, datë 6.3.2012

PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 1 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, nenit 6, germa “b” e ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit znj.Ruko Malko Sako, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, pasi ka mbushur moshën 65 vjeç.

2. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit, të përbërë nga 5 anëtarë:

a) Znj.Diana Toro, Inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira;

b) Znj.Rezarta Koçi, inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira;

c) Z.Erjon Ndreca, inspektor në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira;

d) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë;

e) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Tiranë.

3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Tiranë. Arkivi do t’i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 3-mujor, një noteri publik të Dhomës së Noterisë Tiranë që plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivës dhe që kryen një shërbim sa më të shpejtë e cilësor të të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres Ruko Sako nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.

5. Urdhri t’i njoftohet menjëherë ministrive, Dhomës Kombëtare të Noterisë, gjykatave të shkallës së parë dhe apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi